

MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIN E ZGJEDHJEVE Maqedonia e Veriut - Zgjedhjet presidenciale, Rrethi i dytë, 5 maj 2019

DEKLARATË PËR GJETJET DHE PËRFUNDIMET PARAPRAKE

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Në rrethin e dytë të administruar mirë të zgjedhjeve presidenciale, respektimi i vazhdueshëm i lirive themelore u mundësoi votuesve që zgjedhjen ndërmjet kandidatëve ta bëjnë në bazë të informatave. Mangësitë në rregullativën e fushatës përsëri ishin të dukshme edhe në rrethin e dytë, duke i refelktuar mangësitë më të mëdha në Kodin Zgjedhor. Transparenca e financimit të fushatës u zvogëluar për shkak të raportimit jo të plotë. Dita e zgjedhjeve kaloi pa pengesa, me ç'rast procedurat kyçe në përgjithësi u respektuan në mënyrë transparente.

Pasiqë asnjë kandidat nuk i fitoi votat e nevojshme të shumicës së votuesve të regjistruar për t'u zgjedhur në rrethin e parë më 21 prill, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) e shpalli rrethin e dytë midis Stevo Pendarovskit dhe Gordana Siljanovska-Davkovës për më 5 maj. Edhe pse kërkesa për pjesëmarrje të votuesve prej 40 për qind në rrethin e dytë u arrit në këto zgjedhje, ajo krijon mundësi për cikle të zgjedhjeve të përsëritura.

Korniza ligjore paraqet një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, por nuk i rregullon të gjitha aspektet për mbajtjen e rrethit të dytë, veçanërisht sa i përket fushatës, financimit të fushatës dhe regjistrimit të votuesve. Mangësitë në rregullativë që ishin të dukshme në rrethin e parë mbetën të patrajtuara. Kjo e zvogëloi qartësinë ligjore dhe e potencoi edhe më shumë rëndësinë për reforma legjislative, siç u theksua në Deklaratën për Gjetjet dhe Përfundimet Paraprake të MNZV-së pas rrethit të parë.

Administrata zgjedhore i zhvilloi përgatitjet për rrethin e dytë në mënyrë profesionale dhe të paanshme, dhe në përgjithësi e gëzoi besimin e publikut. Dukshmëria e materialeve për informim të votuesve mbeti e kufizuar. Regjistri i votuesve nuk u përditësua ndërmjet dy rretheve për t'i pasqyruar ndryshimet në të dhënat në regjistrat civilë, gjë që i privoi nga e drejta e votës votuesit që përndryshe e kanë këtë të drejtë, e që është në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare.

Fushata u zhvillua në ambient të qetë dhe paqësor, me ç'rast aktiviteti i fushatës ishte më i qetë se sa para rrethit të parë. Liritë themelore për tubim dhe shprehje vazhduan të respektohen, ndërsa pjesëmarrësit në zgjedhje e zhvilluan fushatën lirshëm dhe pa pengesa. Ashtu sikurse edhe në rrethin e parë, funksionarët shtetërorë u duk se bënë dallim midis detyrave të tyre zyrtare dhe aktiviteteve politike, me ç'rast kishte një numër shumë të vogël të pretendimeve për keqpërdorim të burimeve shtetërore në fushatë. Kandidatët dhe partitë bënë përpjekje për t'iu drejtuar shqiptarëve etnikë dhe romëve, te të cilët pjesëmarrja në rrethin e parë ishte veçanërisht e ulët.

Kandidatët dhe institucionet relevante kishin kuptime të ndryshme për kërkesat për raportim për financimin e fushatës, ndërsa një kandidat nuk e dorëzoi raportin e dytë të përkohshëm. Mungesa e qartësisë dhe moszbatimi i rregullave për raportim e zvogëloi transparencën dhe mbikëqyrjen e financimit të fushatës.

Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it konstatoi se mediat prezantuan informata të ndryshme për kandidatët dhe partitë politike që i mbështetën ata, nëpërmjet programeve të ndryshme dhe debateve televizive me kandidatët. Transmetuesi publik dhe shumica e mediave të monitoruara ofruan

mbulim të paanshëm, gjë që, në tërësi, u ofroi mundësi votuesve të marrin vendim në bazë të informatave.

KSHZ-ja i trajtoi kundërshtimet në lidhje me parregullsitë në rrethin e parë në mënyrë të hapur dhe efektive. Rezultatet e votimit nga rrethi i parë u anuluan në tetë vendvotime dhe anëtarët e këtyre KZ-ve u zëvendësuan. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit i shqyrtoi të gjashtë kundërshtimet brenda afateve ligjore dhe në mbledhje publike, gjë që ofroi transparencë.

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe u administrua mirë. Vlerësimi i përgjithshëm i votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve ishte pozitiv, me ç'rast procedurat kyçe u respektuan. Sikurse në rrethin e parë, disa votues që kishin të drejtë vote, nuk gjendeshin në listat e votuesve. Në disa raste, MNVZ-ja vërejti indikacione të blerjes së votave. Përfaqësuesit e kandidatëve ose vëzhguesit qytetarë ishin të pranishëm në shumicën e vendvotimeve dhe KZK-ve të vëzhguara, dhe kishin mundësi t'i ndjekin të gjitha fazat e procesit. Rezultatet paraprake sipas vendvotimeve u publikuan në kohë në ueb-faqen e KSHZ-së në natën e zgjedhjeve, që e përmirësoi transparencën.

GJETJET PARAPRAKE

Sfondi dhe zhvillimet pas rrethit të parë

Në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale në Maqedoninë e Veriut më 21 prill, asnjëri nga tre kandidatët nuk arriti t'i fitojë votat e nevojshme të shumicës së votuesve të regjistruar për t'u zgjedhur. Dy kandidatët që fituan numrin më të madh të votave ishin Stevo Pendarovski me 42.8 për qind të votave dhe Gordana Siljanovska Davkova me 42.2 për qind. Më 25 prill, KSHZ-ja njoftoi se këta dy kandidatë do të vazhdonin në rrethin e dytë, që do të mbahet më 5 maj. Kandidati i tretë, Blerim Reka, mori 10.6 për qind të votave. Pjesëmarrja e votuesve në rrethin e parë ishte 41.8 për qind. Të gjithë kandidatët shprehën besim të përgjithshëm në procesin e rrethit të parë.

Edhe pse u regjistruan si kandidatë jo-partiakë, të dy kandidatët u mbështetën nga parti politike para regjistrimit dhe përdorën simbole partiake për identifikim në fletëvotim në të dyja rrethet. Z. Pendarovski u mbështet nga blloku politik i udhëhequr nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) në pushtet, si dhe nga partitë kryesisht shqiptare etnike, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Partia Demokratike Shqiptare dhe AlternAtivA. Znj. Siljanovska Davkova u mbështet nga blloku i opozitës i udhëhequr nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE).

Sistemi zgjedhor dhe korniza ligjore

Rrethi i dytë mbahet ndërmjet dy kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave. Në rrethin e dytë zgjidhet kandidati që ka fituar më shumë vota, me kusht që të ketë pjesëmarrje të votuesve prej së paku 40 për qind të votuesve të regjistruar. Përndryshe, i gjithë procesi zgjedhor përsëritet, dhe kryetari i Kuvendit e kryen detyrën e kryetarit të përkohshëm të shtetit. Ligji nuk përcakton se kur duhet të mbahen zgjedhjet e përsëritura. Pasi që nuk ka garanci se në zgjedhjet e përsëritura do të kishte pjesëmarrje më të lartë të votuesve, kjo kërkesë për pjesëmarrje të votuesve në rrethin e dytë krijon mundësi për cikle të zgjedhjeve të dështuara.¹

Në përgjithësi, korniza ligjore paraqet një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, megjithatë Kodi zgjedhor nuk i rregullon të gjitha aspektet për mbajtjen e rrethit të dytë, ndërsa

¹ Në [Mendimin e përbashkët për Kodin Zgjedhor të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të vitit 2011](#) rekomandohet që kërkesa për kufirin e pjesëmarrjes në rrethin e dytë të hiqet. Shih po ashtu [raportet e mëparshme të vëzhgimit nga ODIHR-i në Maqedoninë e Veriut](#).

mangësitë në rregullativë që ishin të dukshme në rrethin e parë mbetën edhe më tej.² Edhe pse shumica e dispozitave të Kodit Zgjedhor vlejné për të dyja rrethet zgjedhore, ligji nuk thotë gjë për çështje të tilla siç është akreditimi i vëzhguesve dhe i përfaqësuesve të kandidatëve, si dhe për ndarjen e hapësirës për bilborde dhe posterë ndërmjet kandidatëve në rrethin e dytë. Ligji gjithashtu nuk është i qartë sa i përket kërkesave për raportim për financimin e fushatës në rrethin e dytë. KSHZ-ja nuk i trajtoi këto çështje përmes rregulloreve. Ashtu sikurse edhe në rrethin e parë, mangësitë rregullore e dëmtuan qartësinë ligjore.

Administrimi i zgjedhjeve

KSHZ-ja i zhvilloi të gjitha përgatitjet për rrethin e dytë në mënyrë profesionale dhe në kohë dhe vazhdoi t'i kryejë të gjitha detyrat kolegjialisht. Pas rrethit të parë, KSHZ-ja mbajti dy mbledhje publike, kushtuar zgjidhjes së kundërshtimeve që kishin të bëjnë me ditën e zgjedhjeve dhe akreditimin e vëzhguesve. Sipas KSHZ-së, problemet teknike në sistemin kyç informatik dhe të komunikimit, të cilat paraqitën sfidë në rrethin e parë, nuk ndikuan në përgatitjet për rrethin e dytë.³ Në përgjithësi, administrata zgjedhore vazhdoi ta gëzonte besimin e publikut para rrethit të dytë.

Përbërja e organeve zgjedhore të nivelit më të ulët mbeti kryesisht e pandryshuar, me përjashtim të disa dorëheqjeve, si dhe shkarkimit të 13 prej 3.396 KZ-ve nga KSHZ-ja për shkak të mangësive procedurale gjatë rrethit të parë (shih *Kundërshtimet dhe ankesat*). Gratë mbetën të përfaqësuara mirë në administratën zgjedhore (rreth dy të tretat e anëtarëve), mirëpo ato përfaqësuan vetëm një të tretën e kryetarëve të KZK-ve.

KZK-të e mirëpritën trajnimin e KSHZ-së për KZ-të para rrethit të parë, që ndihmoi në zvogëlimin e parregullsive procedurale në ditën e zgjedhjeve. Për t'i shmangur gabimet në protokollin me rezultate dhe në protokollin për nxjerrjen e rezultateve në rrethin e dytë, KSHZ-ja vendosi t'i plotësojë paraprakisht disa të dhëna fikse. Ndërmjet dy rrethëve zgjedhore nuk u mbajtën trajnime të standardizuara për KZK-të ose KZ-të, e po ashtu nuk u ofrua trajnim as për të gjithë anëtarët e sapo zgjedhur të KZ-ve. Në disa KZK, trajnime për rifreskim të njohurive ishin në dispozicion në bazë të kërkesës për të gjithë anëtarët e KZ-ve.⁴

Fushata për edukimin e votuesve mbeti relativisht modeste përpara rrethit të dytë, me disa video në gjuhën maqedonase dhe shqipe që u transmetuan nga kanalet televizive publike dhe një kanal privat, si dhe në platformat KSHZ-së në mediat sociale.⁵ Numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme në rrethin e parë KSHZ-ja ia atribuoi prishjes së qëllimshme të fletëvotimeve nga qytetarët, të cilët kështu e shprehën qëndrimin e tyre politik, e jo mosdijes se si ta shënojnë fletëvotimin.⁶ Pavarësisht nga kjo, ligji është i paqartë në lidhje me përcaktimin e fletëvotimeve të pavlefshme.

² Ndryshime të imta në Kodin Zgjedhor u miratuan nga Kuvendi më 27 mars për t'i trajtuar zbrazëtitrat në lidhje me ndarjen e hapësirës për bilborde dhe reklamimin në media. Pas refuzimit nga kryetari i shtetit për t'i nënshkruar këto ndryshime, Kuvendi e hodhi poshtë veton e tij më 24 prill; megjithatë, ato nuk hynë në fuqi para ditës së zgjedhjeve.

³ KSHZ-ja e informoi MNVZ-në se pas zgjedhjeve do të bëhet një revizion i defekteve të sistemit të TIK-ut.

⁴ Për shembull, në KZK-në në Strumicë, ndërsa KZK-ja në Shuto Orizare organizoi një takim të shkurtër me të gjitha KZ-të për t'i qartësuar procedurat për paketimin e materialit zgjedhor.

⁵ Në platformat e KSHZ-së në mediat sociale, videot edukative nga rrethi i parë vazhduan të jenë në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe shqipe, si dhe me titra në gjuhën turke, rome, serbe dhe vllaha. Të gjitha videot përfshinin interpretimin në gjuhën e shenjave në maqedonisht.

⁶ Në rrethin e parë, 4.3 për qind e fletëvotimeve të hedhura u vlerësuan të pavlefshme. Përqindjet më të larta u regjistruan në Çuçer-Sandevë, Makedonska Kamenicë dhe Dellçevë, ku arritën vlerat 7.7, 6.5 dhe 6.2 për qind, respektivisht.

Regjistrimi i votuesve

Regjistri i votuesve nuk përditësohet ndërmjet dy rretheve për t'i pasqyruar ndryshimet në të dhënat në regjistrat civilë. Qytetarët të cilët ishin të përjashtuar nga regjistri i votuesve për shkak të skadimit të afatit të vlefshmërisë së dokumenteve të identifikimit, sikurse edhe ata që i mbushën 18 vjet në periudhën ndërmjet dy rretheve zgjedhore, ishin të privuar nga e drejta e votës, që është në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare.⁷ Votuesit të cilët u regjistruan për votim jashtë vendit ose për votim në shtëpi për rrethin e parë u përfshinë automatikisht në këto lista të votuesve për rrethin e dytë, e po ashtu deri më 27 prill u pranuan kërkesat shtesë për votim në shtëpi.

Fushata

Fushata për rrethin e dytë rifilloi në ditën e ardhshme pas rrethit të parë, por ishte me intensitet të ngadalshëm në shumicën e rajoneve të vendit. Ashtu sikurse në rrethin e parë, fushata u zhvillua në një ambient të qetë dhe paqësor, në të cilin pjesëmarrësit në zgjedhje e zhvilluan fushatën lirshëm dhe pa pengesa, me ç'rast u respektuan liritë themelore për tubim dhe shprehje. Periudha e shkurtër e fushatës u përputh me festën ortodokse të Pashkëve dhe Ditën e Punës dhe ishte më e qetë se sa në rrethin e parë. Të dy kandidatët iu shmangën tubimeve të mëdha të fushatës në favor të ngjarjeve më të vogla. Fushata u zhvillua kryesisht në media, duke përfshirë reklamën e paguara dhe debatet ndërmjetkandidatëve. Pozitivisht, u organizua një ngjarje e fushatës nga komuniteti rom, ku morën pjesë të dy kandidatët presidencialë dhe u promovua pjesëmarrja e votuesve romë.

Kandidatët dhe partitë e tyre mbështetëse me aktivitetet dhe mesazhet e tyre synonin grupe të caktuara për ta rritur numrin e votave të tyre nga rrethi i parë. Çështjet që kanë të bëjnë me Marrëveshjen e Prespës, integrimin në NATO dhe BE, si dhe sundimin e ligjit vazhduan të dominojnë në diskursin e fushatës. Të dyja palët përdorën mesazhe negative të fushatës. Për shembull, fushata e z. Pendarovskit paralajmëroi se zgjedhja e kundërshtarit të tij do të rrezikonte që vendi të kthehet në atë që ajo e portretizoi si "vitet e errëta" të qeverisë së mëparshme të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja, përderisa fushata e znj. Siljanovska Davkova vuri në dukje korrupsionin dhe nepotizmin e pretenduar në qeverinë aktuale të udhëhequr nga LSDM-ja. Përkundër tonit negativ të fushatës, MNVZ-ja nuk vërejtë raste të retorikës nxitëse gjatë diskursit të fushatës.

Të dy kandidatët iu drejtuan votuesve shqiptarë etnikë, të cilët pjesëmarrja në rrethin e parë ishte veçanërisht e ulët. Z. Pendarovski vazhdoi ta potencojë rëndësinë e kohezionit ndëretnik. Ndryshe nga rrethi i parë, fushata e znj. Siljanovska Davkova përgatiti reklama edhe në gjuhën shqipe. Ambienti i fushatës në mesin e shqiptarëve etnikë u ndikua nga veprimet ligjore për ta larguar kreun e Bashkësisë Fetare Islame, të cilat u kritikuan nga personalitetet e shquara etnike shqiptare, si ndërhyrje e pajustificuar.⁸ Aktiviteti i fushatës së BDI-së fitoi në intensitet vetëm në ditët e fundit të fushatës. Z. Reka i inkurajoi përkrahësit e tij që të "votojnë me qëllim që ta shpëtojnë procesin euro-atlantik", sikurse edhe udhëheqësit e Bashkësisë Fetare Islame.⁹ Partitë, Aleanca për Shqiptarët dhe BESA, të cilat e kishin mbështetur z. Reka në rrethin e parë, nuk e mbështetën asnjë kandidat të mbetur.

⁷ Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, rreth 44.392 qytetarë i rinovuan dokumentet e tyre të identifikimit që kur u shpallën zgjedhjet, dhe 1.145 qytetarë i mbushën 18 vjet midis 22 prillit dhe 5 majit. Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) i obligon vendet pjesëmarrëse ta "garantojnë votim universal dhe të barabartë për qytetarët moshë rritur". Paragrafi 11 i [Komentit të përgjithshëm nr. 25 të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të KB-ve](#) të vitit 1996, kërkon që shtetet "të marrin masa efektive për të siguruar se të gjithë personat me të drejtë vote të mund ta ushtrojnë këtë të drejtë". Në rastet kur kërkohet regjistrimi i votuesve, kjo duhet të lehtësohet dhe nuk duhet të vendosen pengesa për regjistrimin e tillë."

⁸ Më 17 prill, një gjykatë themelore në Shkup e konfirmoi dorëheqjen dhe zëvendësimin e *Reis ul Ulemasë*, Sulejman Rexhepit. Z. Rexhepi mohoi se kishte dhënë dorëheqje dhe pohoi se procedura ishte falsifikuar.

⁹ Shumica e bashkëbiseduesve të MNVZ-së e interpretuan këtë deklaratë si mbështetje indirekte për z. Pendarovskin.

Në pjesën më të madhe të rasteve, funksionarët shtetërorë u duk se mbajtën dallim të qartë ndërmjet detyrave të tyre zyrtare dhe aktiviteteve politike dhe u përmbajtën nga keqpërdorimi i burimeve shtetërore për fushatë.¹⁰ MNVZ-ja pranoi disa pretendime për presion mbi punonjësit në sektorin publik, sidomos në jugperëndim të vendit, si dhe pretendime për blerjen e votave duke përfshirë dhënien falas të druve për ngrohje. Këto pretendime nuk mundën të vërtetohen nga MNVZ-ja. Një mjet onlajn i krijuar nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë për t'u mundësuar punonjësve të sektorit publik që t'i denoncojnë në mënyrë anonime rastet e presionit mbi ta ishte edhe më tej në dispozicion, mirëpo, sikurse edhe në rrethin e parë, nuk kishte denoncime të parashtruara.

Financimi i fushatës

Kodi Zgjedhor përcakton një kufi të shpenzimeve për fushatën, mirëpo nuk thekson në mënyrë të qartë se kjo a vlen për njërin apo për të dyja rrethet zgjedhore. KSHZ-ja dhe Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) e informuan MNVZ-në se kufiri i shpenzimeve prej 110 denarë për votues të regjistruar (që kap vlerën prej rreth 198 milionë denarësh ose 3.2 milionë eurosh) vlen për të dyja rrethet zgjedhore së bashku.¹¹ Shpenzimet më të mëdha në këto zgjedhje u bënë për reklamimin në media, të cilat pastaj do të kompensohen nga buxheti shtetëror.¹²

Kandidatët dhe institucionet relevante kishin kuptime të ndryshme për kërkesat për raportim për financimin e fushatës. Përderisa dy kandidatë dorëzuan dy raporte të përkohshme para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë ashtu siç kërkohet me ligj, znj. Siljanovska Davkova dorëzoi vetëm një raport të përkohshëm.¹³ Për më tepër, kandidatët përdorën shabllone të ndryshme për raportim.¹⁴ Mungesa e qartësisë dhe moszbatimi i rregullave për raportim e zvogëloi transparencën e financimit të fushatës dhe efektivitetin e mbikëqyrjes, që është nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare.¹⁵

Para ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë, të dy garuesit dorëzuan raporte të përkohshme në KSHZ, ESHR dhe në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Këto raporte nuk u publikuan në ueb-faqet e tyre para ditës së zgjedhjeve. Raportet e përkohshme financiare nuk i nënshtrohen analizës së detajuar, gjë që e pengon zbulimin e hershëm të parregullsive.

¹⁰ MNVZ-ja pranoi një denoncim për pjesëmarrjen e një funksionari shtetëror në ngjarje të fushatës gjatë orarit të punës në Shkup.

¹¹ 1 euro është përafërsisht 61 denarë. Sipas marrëveshjes ndërpartiake në rrethin e parë, të dy garuesit gjoja u pajtuan që secili prej tyre të mos e tejkalojë kufirin e shpenzimeve prej 1.4 milionë eurosh.

¹² Të ardhurat e paraqitura nga z. Pendarovski në rrethin e parë ishin rreth 18 milionë denarë, kurse ai shpenzoi rreth 17 milionë denarë, e po ashtu shpenzoi edhe rreth 26 milionë denarë të tjera për reklamim në media. Z. Reka paraqiti të hyra prej rreth 1.1 milionë denarë, dhe shpenzime prej rreth 1.6 milionë denarë, e po ashtu edhe rreth 17 milionë denarë të tjera të shpenzuara për reklamim në media. Znj. Siljanovska Davkova nuk dorëzoi raport të dytë para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, mirëpo raporti i saj i parë i datës 11 prill zbuloi të ardhura prej rreth 12 milionë denarësh dhe rreth 2.2 milionë denarë të shpenzuara, e po ashtu edhe rreth 29 milionë denarë të tjera për reklamim në media.

¹³ Kodi Zgjedhor (neni 84-b) parasheh dorëzimin e raportit të dytë të përkohshëm për gjysmën e dytë të fushatës, një ditë pas përfundimit të fushatës.

¹⁴ Z. Pendarovski e përdori shabllonin e ri të paraparë për raportim që përfshinte ndarje të detajuar të shpenzimeve në të dyja rrethet zgjedhore. Znj. Siljanovska Davkova përdori një shabllon të vjetëruar dhe më pak të detajuar, ndërsa z. Reka fillimisht e përdori shabllonin e vjetëruar, mirëpo raportin e tij të dytë e dorëzoi në shabllonin e ri të paraparë.

¹⁵ Neni 7.3 i [Konventës së KB-ve Kundër Korrupsionit të viti 2003](#) kërkon nga vendet që “të konsiderojnë marrjen e masave të përshtatshme legjislative dhe administrative [...] për ta rritur transparencën në financimin e kandidaturave për funksionet e zgjedhura publike dhe kur është e mundur, financimin e partive politike”. Shih po ashtu paragrafët 212 dhe 220 të [Udhëzimit për Rregullativën për Partitë Politike të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të vitit 2011](#).

Mediat

Korniza ligjore për mediat në rrethin e dytë të fushatës mbeti e pandryshuar. Rregullat për mbulimin e fushatës së partive politike u zbatuan edhe për kandidatët presidencialë në bazë të marrëveshjes politike të ndërmjetësuar nga qeveria dhe partitë politike parlamentare, gjatë rrethit të parë.¹⁶ Transmetuesi publik ishte i obliguar të emetojë promovim politik falas, ndërsa mediat private, duke i përfshirë edhe portalet në internet, kishin të drejtë të ofrojnë reklama të paguara.¹⁷

Secila nga 182 mediat private që u përcaktua të ofrojë reklama të paguara në rrethin e parë kishte të drejtë të vazhdojë me këtë edhe në rrethin e dytë. KSHZ-ja është e obliguar t'i kompensojë shpenzimet për reklama në bazë të faturave të dorëzuara nga mediat, ndërsa në rastin e mediave transmetuese, në bazë të raporteve të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM).¹⁸ KSHZ-ja i procesoi kompensimet gjatë gjithë periudhës së fushatës, por shumat e mjeteve shtetërore që iu paguan transmetuesve nuk u publikuan para ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë.¹⁹

ASHAAM-i e monitoroi respektimin nga ana e mediave të kërkesave për mbulimin e drejtë, të balancuar dhe të paanshëm të fushatës, dhe më 25 prill e publikoi raportin e tij të katërt nga monitorimi, i cili e përfshinte gjysmën e dytë të fushatës së rrethit të parë.²⁰ Siç kërkohet me ligj, ASHAAM-i i jepte informata KSHZ-së për çdo ditë, mirëpo një raport gjithëpërfshirës nga monitorimi i mbulimit të rrethit të dytë do të publikohet më pas.

Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it në rrethin e dytë konstatoi se, në përgjithësi, shumica e mediave të monitoruara prezantuan informata të ndryshme për kandidatët dhe partitë politike që i mbështesin ata.²¹ Programet e ndryshme politike, reklamat e paguara dhe tre debatet televizive me kandidatët kontribuan që votuesit të kenë mundësi të marrin vendim në bazë të informatave.²²

Pas rrethit të parë, mbulimi i zvogëluar mediatik e reflektoi rënien e aktivitetit të fushatës nga kandidatët.²³ Pavarësisht nga kjo, shumica a kanaleve të monitoruara i mbuluan garuesit dhe partitë që i mbështesin ata në mënyrë të barabartë, me kohë përfaqësisht të barabartë transmetimi dhe me ton të balancuar. Kanalet publike *RTM1* dhe *RTM2* i kushtuan 28 dhe 18 për qind të mbulimit politik znj. Siljanovska Davkova, respektivisht, dhe 19 dhe 14 për qind z. Pendarovski, me ç'rast të dyja kanalet kishin informata kryesisht neutrale. Megjithatë, kanali privat *Alfa*, edhe pse prezantoi mbulim të balancuar të kandidatëve, tregoi mbulim negativ të LSDM-së dhe të kryeministrit. Portali onlajn *kurir.mk* përsëri prezantoi trajtim të favorshëm të znj. Siljanovska Davkova dhe të VMRO-DPMNE-së, ndërsa mbulimi i z. Pendarovskit dhe i LSDM-së ishte kryesisht negativ. Në kanalet private të

¹⁶ Sipas kësaj marrëveshjeje, kandidatëve të mbështetur nga dy partitë më të mëdha politike do t'u takonte shumë e barabartë e mjeteve publike për reklamat e tyre të paguara në media.

¹⁷ Sipas transmetuesit publik, nuk kishte kërkesa për promovim politik nga garuesit dhe, ndryshe nga rrethi i parë, ai nuk organizoi intervista individuale me kandidatët.

¹⁸ ASHAAM-i i monitoron reklamat e paguarat politike në 27 transmetues privatë dhe dorëzon raporte në KSHZ në ditën e 10-të të fushatës zgjedhore dhe në ditën e 7-të pas përfundimit të fushatës.

¹⁹ KSHZ-ja është e obliguar të paguajë dy herë për këto shpenzime: në ditën e 12-të të fushatës zgjedhore, mirëpo jo më vonë se 10 ditë pas përfundimit të fushatës.

²⁰ ASHAAM-i identifikoi një shkelje të kërkesave që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe inicioi procedurë kundërvajtëse kundër *ITV*.

²¹ Monitorimi u bë çdo ditë nga ora 18:00 deri në orën 24:00 në kanalet *RTM1* dhe *RTM2* (në gjuhën maqedonase dhe shqipe, respektivisht) dhe kanalin privat *Alfa* (në gjuhën maqedonase), *Alsat-M* (dygjuhësh), *Kanal 5*, *Sitel*, *Telma*, *24 Vesti* (në gjuhën maqedonase). U monitoruan edhe artikujt që kanë të bëjnë me politikën të gazetave private *Koha* (në gjuhën shqipe), *Nezavisen Vesnik*, *Nova Makedonia* dhe *Sloboden Peçat* (në gjuhën maqedonase), si dhe të mediave onlajn www.kurir.mk (në gjuhën maqedonase), www.lajmpress.mk (në gjuhën shqipe), www.plusinfo.mk dhe www.sdk.mk (në gjuhën maqedonase).

²² Më 3 maj, gazeta *Nova Makedonija* publikoi pyetje dhe përgjigje të ndërsjella ndërmjet kandidatëve.

²³ Mediat u kushtuan vëmendje të konsiderueshme ngjarjeve që dallonin nga gara presidenciale, duke përfshirë kontestin për pozitën e kryetarit brenda Bashkësisë Fetare Islame dhe samitin ndërqeveritar për Ballkanin Perëndimor në Berlin.

monitoruara, mbulimi i aktiviteteve të qeverisë në përgjithësi u zvogëluar në krahasim me rrethin e parë, mirëpo mbulimi i kryeministrit ishte më i madh (ndërmjet 8 dhe 15 për qind), dhe ishte kryesisht me ton neutral.

Kundërshtimet dhe ankesat

Kundërshtimet në lidhje me parregullsitë gjatë votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve, kandidatët në zgjedhje i dorëzojnë në KSHZ, për vendimet e së cilës mund të parashtrohen ankesa në Gjykatën Administrative. KSHZ-ja pranoi 14 kundërshtime të tilla në lidhje me ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë, të gjitha të parashtuara nga përfaqësuesit e znj. Siljanovska Davkova.²⁴ Kodi Zgjedhor kërkon që KSHZ-ja t'i anulohet rezultatet e vendvotimeve në rast të parregullsive procedurale, duke përfshirë edhe rastet kur në kutinë e votimit ka tepriç të fletëvotimeve ose kur votimi ndërpritet për më shumë se tre orë. Duke u bazuar në shqyrtimin e këtyre kundërshtimeve, rezultatet e votimit u anuluan në shtatë vendvotime.²⁵ Rezultatet e votimit në një vendvotim tjetër u anuluan me iniciativë të vetë KSHZ-së për shkak të mospërputhjeve në protokollet e rezultateve. Shtatë ankesa u hodhën poshtë si të pabaza. Edhe pse disa kundërshtime nuk i plotësonin kërkesat formale për dorëzim, pozitivisht, KSHZ-ja megjithatë e shqyrtoi arsyeshmërinë e këtyre rasteve. Në tre raste KSHZ-ja i shqyrtoi materialet zgjedhore, dhe në dy raste bëri rinumërim e fletëvotimeve. Përveç kësaj, KSHZ-ja pranoi dhe miratoi pesë kundërshtime para ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë në lidhje me kërkesat e votuesve në shtëpi, të cilëve nuk u ishte lejuar të votojnë në rrethin e parë. KSHZ-ja vendosi për të gjitha rastet në mbledhje të hapura dhe i publikoi vendimet onlajn, që kontribuoi për transparencë.

KSHPK-ja, e cila ka mandat të reagojë ndaj keqpërdorimeve të mundshme të burimeve shtetërore, pranoi gjashtë kundërshtime para rrethit të dytë të votimit, në të cilin VMRO-DPMNE-ja pretendonte se janë bërë shpenzime të paligjshme buxhetore dhe keqpërdorim të automjeteve dhe hapësirave në pronësi shtetërore. Këto kundërshtime u hodhën poshtë si të pabaza. KSHPK-ja vendosi të iniciojë dy procedura kundërvajtëse kundër kryetarit aktual për emërimet dhe promovimet në ushtri, pas shpalljes së zgjedhjeve. Të gjitha rastet u shqyrtuan nga KSHPK-ja brenda afateve ligjore, në mbledhje publike, dhe vendimet për të inicuar procedura u publikuan brenda 24 orëve, gjë që ofroi transparencë.

Vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgimin e të gjitha fazave të procesit zgjedhor nga vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë, por nuk e rregullon në mënyrë eksplicite akreditimin për rrethin e dytë. Në mënyrë inkluzive, periudha e zgjatur për akreditim që u prezantua nga KSHZ-ja para ditës së parë të zgjedhjeve u vazhduar pa përcaktuar ndonjë afat të ri, dhe akreditimet e lëshuara për rrethin e parë u konsideruan të vlefshme edhe për rrethin e dytë. Gjithsej, 3.381 vëzhgues qytetarë, 520 vëzhgues ndërkombëtarë, si dhe një numër shumë i madh i përfaqësuesve të kandidatëve u regjistruan për ta vëzhguar rrethin e dytë. Disa organizata të personave me aftësi të kufizuara, si për shembull "Inkluziva", po ashtu i vëzhguan zgjedhjet.

Dita e zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve kaloi pa pengesa dhe u administrua mirë. Përfaqësuesit e kandidatëve ose vëzhguesit qytetarë ishin të pranishëm në shumicën e vendvotimeve të vëzhguar, gjë që ofroi shkallë të lartë të transparencës. Anëtarët e administratës zgjedhore ishin të përzemërt dhe bashkëpunues. Gratë ishin të

²⁴ Këto pretendime përfshinin atë se votuesve u janë dhënë fletëvotime shtesë ose fletëvotime me bllokun-amë, se njerëzve që nuk janë në listën e votuesve u është lejuar të votojnë, se fletëvotimet e pavlefshme janë përcaktuar në mënyrë të gabuar dhe se është bërë mbushja e kutive të votimit.

²⁵ Duke e pranuar shkallën e ulët të këtyre shkeljeve, KSHZ-ja i anuloi rezultatet edhe në rastet kur u gjetën një numër i vogël i fletëvotimeve shtesë. Korniza ligjore nuk i rregullon procedurat e rinumërimit.

përfaqësuara mirë në organet e ndryshme zgjedhore, me ç'rast ato përfaqësonin rreth dy të tretat e të gjithë anëtarëve dhe dy të tretat e kryetarëve.

Votimi i hershëm u mbajt një ditë para ditës së zgjedhjeve për personat që votojnë në shtëpi, si dhe votuesit në spitale të caktuara dhe institucionet ndëshkuese. Në të gjitha 12 vëzhgimet e MNVZ-së, procesi ishte i rregullt dhe procedurat kryesisht u ndoqën. Në një vëzhgim, u shprehën shqetësime në lidhje me fshehtësinë, për shkak se zarfet me fletëvotimet nuk ishin mbyllur si duhet. Disa votues nuk kishin mundësi të votojnë për shkak se nuk ishin në lista ose nuk i kishin dokumentet e nevojshme të identifikimit.

Hapja u vlerësua pozitivisht në të gjitha 64 vendvotimet e vëzhguara. KZ-të i kishin të njohura procedurat dhe kryesisht i ndoqën ato, edhe pse në 10 raste KZ-të nuk i plotësuan protokollat para fillimit të votimit. Shumica e vendvotimeve u hapën në kohë ose me një vonesë të shkurt. Në një vëzhgim, hapja u shty për më shumë se një orë për shkak të zëvendësimit të listave të votuesve që ishin shtypur gabimisht.

Votimi ishte i organizuar mirë dhe procesi u vlerësua pozitivisht në 99 për qind të vëzhgimeve të MNVZ-së. Procedurat kyçe u ndoqën gjatë gjithë ditës, duke përfshirë edhe kontrollimin dhe shënimin me ngjyrë të gishtave të votuesve, kontrollimin e letërnjoftimeve, dhe nënshkrimin në listat e votuesve. Një numër shumë i vogël i vlerësimeve negative kishte të bëjë me hapësirat joadekuate për votim, gjë që në disa raste e komprometoi fshehtësinë e votës. Sikurse në rrethin e parë, u vërejtën raste të votimit familjar (në 3 për qind të vëzhgimeve), që ndikon në mënyrë disproporcionale në pjesëmarrjen e grave. Prosesi i votimit në përgjithësi ishte transparent, edhe pse në disa raste vëzhguesve të MNVZ-së nuk iu lejua ta shihnin listën e votuesve. Gjatë ditës, MNVZ-ja pranoi disa pretendime të besueshme për blerje të votave, e cila poashtu vërejtë dy indikacione të blerjes së votave në Shtip dhe Strumicë.

Edhe pse KSHZ-ja mori masa për ta rritur numrin e vendvotimeve që kanë qasje pa pengesa fizike, 59 për qind e vendvotimeve të vëzhguara nuk mundësuan qasje të pavarur për votuesit me aftësi të kufizuara fizike. Shabllon me alfabet të Brejtit për votuesit me shikim të dobësuar kishte në të gjitha, përveç në nëntë vendvotime, edhe pse bashkëbiseduesit e MNVZ-së theksuan se këto pajisje u përdorën rrallë.

Numërimi u vëzhgua në 71 vendvotime. Edhe pse ai u bë në mënyrë efikase, vëzhguesit vërejtën se kjo u bë me ngut dhe në shumicën e rasteve KZ-të nuk i kryen procedurat e parapara para hapjes së kutive të votimit, duke përfshirë numërimin e nënshkrimeve në listat e votuesve (20 raste), konstatimin e numrit të fletëvotimeve të shfrytëzuara (20 raste), dhe prishjen e fletëvotimeve të mbetura si të papërdorshme (14 raste). Vetë procedurat e numërimit u respektuan mirë, me ç'rast fletëvotimet u numëruan saktësisht dhe fletëvotimet e pavlefshme u përcaktuan në mënyrë konsekuente. Transparenca e numërimit u përmirësua me prezencën e përfaqësuesve të kandidatëve (59 raste) dhe të vëzhguesve qytetare (16 raste), mirëpo KZ-të nuk publikuan kopje të protokolleve me rezultatet në vendvotime në 29 raste. Sikurse në rrethin e parë, ekzistimi i 82 KZ-ve me më pak se 10 votues të regjistruar e komprometuan fshehtësinë e votës gjatë numërimit, pasi që ka mundësi të lidhen rezultatet me votuesit individualë.²⁶

Nxjerrja e rezultateve u vlerësua pozitivisht në të gjitha 61 KZK-të e vëzhguara. Megjithëse vëzhguesit vërejtën organizim të mirë të procesit, hapësirat u vlerësuan si joadekuate në katër raste. Mospërputhjet në protokollat me rezultatet kryesisht u zgjidhën nga KZK-të, duke i rishqyrtuar materialet zgjedhore, megjithatë, në disa raste nga KZ-të u kërkua që rinumërimin të bëjnë vetë ata, gjë që e potencoi mungesën e udhëzimit të njëtrajtshëm për këtë fazë të procesit.

²⁶

Edhe pse KSHZ-ja i caktoi këta votues në vendvotime më të mëdha, fletëvotimet e tyre hidheshin në kuti të veçantë të votimit dhe u numëruan veçmas.

KSHZ-ja publikoi informata për pjesëmarrjen e votuesve gjatë gjithë ditës dhe i publikoi rezultatet e plota të përkohshme para mesnatës, të ndara sipas vendvotimeve. KSHZ-ja njoftoi se pjesëmarrja përfundimtare e votuesve ishte 46.7 për qind. Akuza për parregullsi u emetuan gjatë ditës nga VMRO-DPMNE-ja, e cila po ashtu pretendoi se votuesit padrejtësisht ndikoheshin nga partitë në pushtet. KSHZ-ja pranoi tetë kundërshtime nga qytetarë që nuk ishin të përfshirë në listat e votuesve. Në natën e zgjedhjeve, edhe pse të dy kandidatët i pranuan rezultatet e zgjedhjeve, kryetari i VMRO-DPMNE-së e përsëriti pohimin e tij të mëparshëm se znj. Siljanovska Davkova mund të humbte vetëm si rezultat i inxhinieringut zgjedhor.

INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

Shkup, 6 maj 2019 – Kjo Deklaratë për gjetjet dhe përfundimet paraprake është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) të OSBE-së, Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (AP të OSBE-së) dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE). Vlerësimi u bë që të caktohet se a u mbajtën zgjedhjet në përputhje me përkushtimet e OSBE-së, Këshillit të Evropës së për dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin shtetëror.

Znj. Sereine Mauborgne u zgjodh nga kryesuesi i OSBE-së si koordinatore e posaçme dhe udhëheqëse e misionit vëzhgues afatshkurtër të OSBE-së dhe e udhëhoqi delegacionin e AP të OSBE-së. Znj. Marie-Christine Dalloz e udhëhoqi delegacionin APKE-së. Znj. Corrien Jonker është shefi i MVZ-së së ODIHR-it, që filloi me punë më 11 mars.

Secila nga institucionet e përfshira në këtë Mision Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve e kanë miratuar Deklaratën e parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005. Kjo Deklaratë për gjetjet dhe përfundimet paraprake është dorëzuar para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit, duke përfshirë numërimin, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e kundërshtimeve dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. ODIHR-i do të publikojë një raport gjithëpërfshirës përfundimtar, duke përfshirë rekomandime për përmirësime eventuale, diku rreth dy muaj pas përfundimit të procesit zgjedhor. AP-ja e OSBE-së do t'a paraqesë raportin e saj në korrik në Luksemburg. APKE-ja do t'a paraqesë raportin e saj në mbledhjen e Komitetit të Përherëshëm më 24 maj në Paris.

Për rrethin e dytë, MVZ-ja e ODIHR-it përfshinte 11 ekspertë në kryeqytet dhe 16 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë anembanë vendit. Në ditën e zgjedhjeve u shpërndanë 172 vëzhgues nga 32 vende, duke përfshirë 136 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të shpërndarë nga ODIHR-i, si dhe një delegacion 11-anëtarësh nga AP-ja e OSBE-së dhe një delegacion 5-anëtarësh nga APKE-ja. Hapja u vëzhgua në 64, ndërsa votimi u vëzhgua në 688 vendvotime anembanë vendit. Numërimi i votave u vëzhgua në 71 vendvotime, ndërsa nxjerrja e rezultateve në 61 KZK. Votimi i hershëm u vëzhgua në 13 vendvotime speciale një ditë para ditës së zgjedhjeve.

MNVZ-ja dëshiron t'i falënderojë autoritetet për ftesën për t'i vëzhguar zgjedhjet dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për ndihmën e tij. MNVZ-ja poashtu dëshiron ta shprehë falënderimin e saj ndaj institucioneve të tjera, partive politike, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

Për informata plotësuese ju lutemi kontaktoni:

- Corien Jonker, Shefe i MVZ-së së ODIHR-it në Shkup (+389 72 443 752);
- Katya Andrusz, Zëdhënëse e ODIHR-it (+389 72 807 826 ose +48 609 522 266), ose Keara Castaldo, Këshilltare për zgjedhjet e ODIHR-it, në Varshavë (+48 603 638 999);
- Andreas Baker, AP-ja e OSBE-së (+389 70 636 321 ose +45 601 08126);
- Chemavon Chahbazian, APKE (+389 70 636 302 ose +33 650 687 655).

Adresa e MVZ-së së ODIHR-it:

Nikola Klusev 6

1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

Tel: +389 2 3222558; Fax: +389 2 3226776; E-mail: office@odih.mk

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*